



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1598 Prot

Tiranë, më 14/10/2019

REKOMANDIM

Nr. 38, datë 14/10/2019

PËR PROGRAMIN E TRANSPARENCËS
SË AUTORITETIT PUBLIK "BANKA E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 6, 7 të Ligjit 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", shkronjës f) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të ligjit 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka kryer monitorimin on-line në faqen zyrtare https://www.bankofalbania.org/Aksesi_ne_informacion/ të autoritetit publik "Banka e Shqipërisë" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Autoritetet Publike bazuar në pikën 1 të nenit 4 të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", kanë detyrimin të vënë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publik të këtij informacioni.

Gjithashtu, bazuar në pikën 2 të po të njëjtës dispozitë, në përgatitjen e programit të transparencës, Autoriteti Publik mban parasysh interesin më të mirë të publikut dhe sidomos:

- a) garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik;
- b) vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion;
- c) modelet e miratuara për kategorinë e autoritetit publik nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të këtij ligji.

Ky program, vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Autoriteti Publik ndërton dhe rrit transparencën në veprimtarinë e tij institucionale, nëpërmjet përditësimit dhe

pasurimit të vazhdueshëm të Programit të Transparencës, në referencë edhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Në përputhje me programin e transparencës të miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e informacionit të përcaktuara në nenin 7 të ligjit të sipërcituar.

Në kuadër të respektimit të detyrimeve të përcaktuara në ligj, u krye monitorimi me qëllim verifikimin e zbatimit të programit të transparencës në faqen zyrtare të autoritetit publik. Nga monitorimi rezultoi se, Autoriteti Publik ka publikuar në shiritin e menu-së kryesore, menu-në “Rreth Bankës”, në të cilën programi i transparencës shfaqet si një nën menu.

Nga monitorimi i faqes zyrtare rezultoi se, kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t’u bërë publik pa kërkesë në përputhje me nenin 7 të ligjit, janë pasqyruar në mënyrë jo të plotë në menu të ndryshme të faqes zyrtare të autoritetit publik.

Programi i transparencës duhet të jetë i plotësuar me të gjithë elementët sikurse parashikohet në ligj si dhe i plotësuar me informacion specifik sipas fushës së veprimtarisë së çdo Autoriteti Publik.

Në lidhje me monitorimin e kryer, Zyra e Komisionerit vlerëson se problematikat e evidentuara konsistojnë në mosvënien në zbatim të programit të transparencës, në përputhje me modelin e miratuar nga Komisioneri. Këtu përfshihet mospublikimi i programit me shpjegimet përkatëse si dhe tabela me kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t’u bërë publik. Tabela duhet të ndërtohet në format të tillë, që nëpërmjet klikimit, të mundësohet ndërlidhja me menutë, rubrikat ku gjendet informacioni, ose të përshkruhet në tabelë vendndodhja e informacionit.

Nga monitorimi u konstatua se nuk është publikuar informacioni në përputhje me nenin 7 pika 1 e ligjit, konkretisht për gërmat:

e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim;

h) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;

Disa kategori informacioni, të detyrueshme për t’u publikuar në përputhje me dispozitën e sipërcituar, rezultojnë të publikuara në menu të tjera të faqes, por nuk janë të publikuara sipas modelit të miratuar nga Komisioneri. Konkretisht informacioni si më poshtë:

dh) raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit;

ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit /partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë

20.12.2006, "Për prokurimin publik", dhe të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;

Në përfundim, bazuar në provat dhe konstatimet që rezultuan nga monitorimi, u hartua raporti i monitorimit.

Komisioneri vlerëson se, pavarësisht se një pjesë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë është publikuar në faqen zyrtare, Autoriteti Publik duhet ti përmbahet programit model të transparencës të miratuar nga Komisioneri.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 4, 5, 6, 7 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", shkronjës f) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Autoriteti Publik/Banka e Shqipërisë, në zbatim gërmave a), b), c) të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 5 të ligjit 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të rishikojë/përditësojë programin e transparencës;
2. Autoriteti Publik duhet të pasqyrojë, në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7 të ligjit;
3. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 1 dhe 2 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 90 (nëntëdhjetë) ditor nga momenti i marrjes dijeni;
4. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 18, 19 dhe 20 të ligjit nr. 119/2014, "Për të Drejtën e Informimit".

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 14.10.2019

KOMISIONERI

Besnik Dervishi




Raport monitorimi mbi implementimin e programit të transparencës së Autoritetit Publik/ Banka e Shqipërisë – datë 19.09.2019

1. Banka e Shqipërisë ka publikuar programin e transparencës ne faqen zyrtare ne linkun https://www.bankofalbania.org/Akresi_ne_informacion/;




Programi i transparencës është i publikuar në përputhje me programin model të transparencës të miratuar sipas Urdhërit nr.14 date 22.01.2015.




7.1.a) Një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik.


Informacioni është i publikuar në faqe;




7.1.b) tekstet e plota: i) të konventave që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë; ii) të ligjeve; iii) të akteve nënligjore; iv) të kodeve të sjelljes; v) të çdo dokumenti politikash; vi) të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik dhe që prek publikun e gjerë. **Informacioni është i publikuar në faqe;**



7.1.c) informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës; **Informacioni është publikuar në faqe;**



7.1.ç) të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit; **Informacioni është i publikuar në faqe;**



7.1.d) një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime. **Informacioni është pjesërisht i publikuar.**

Bank of Albania (BA) | bankofalbania.org/ro/en/.../Z.Gent-SEKO

Jetëshkrimi

Z. Gent SEKO



Nga muaji shkurt 2015, Z. Gent Seko është Guvernatori i Bankës së Shqipërisë dhe njëkohsisht Kryetar i Këshillit Mbrojtës të saj. Ai u zgjodh në këtë pozicion nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 5 shkurt 2015, bazuar në Dekretin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

Z. Seko ka mbaruar studimet në vitin 1992 pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, i diplomuar si ekonomist industrial, në vitin 1997, këtu studimet pasuniversitare dhe zgjidhjen diplomën Master në Komputimet Ndërkombëtare dhe Menaxhimi Financiar (MBA) nga Universiteti i Glasgow-it, Skotit, ku ka mbaruar titullin e disertacionit "Roli i Bankave dhe Privatizimi i Bankave në ekonomitë në tranzicion".

Zot. Seko e ka filluar karrierën bankare në vitin 1992 pranë Bankës Komerciale Tregtare e Përgjegjëse (Sektorit të Kreditit dhe Përcaktimit të Bankës së Shqipërisë si Inspektor Mbrojtës në Departamentin e Mbrojtjes, pozicion të cilit e ka mbajtur deri në vitin 1998, me shkëputje për studimet postuniversitare.

Në periudhën 1998 – 2000, Z. Seko ka punuar pranë firmës Deloitte & Touche, si auditor i lartë dhe konsulent me detyrime përgjegjëse për menaxhimin e procesit të auditimit.

Në periudhën 2001 – 2002, ai ka punuar pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë si Drejtor i Divizionit të Auditimit të Brendshëm dhe Përcaktimit të Bankës së Shqipërisë për hapjen e rrjetëve të kësaj banke.

Në periudhën 2002 – 2004, Zoti Seko ka punuar pranë Bankës së Shqipërisë në pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Kalkulimit të Vlerës në Departamentin e Mbrojtjes.

Në periudhën 2004 – 2010, ai ka mbajtur pozicionin të Ndihësive Shërbuese pranë Bankës Raffesien si Drejtor i Divizionit të Auditimit të Brendshëm, Përcaktimit të Bankës së Shqipërisë dhe Guvernator, Drejtor i Përcaktimit të Raffesien Leasing sh.a., Drejtor i Divizionit të Kuponave Raffesien Bank, dhe më tej tërësi ka shërbyer edhe si anëtar i Komitetit të Kreditit të Bankës anëtar i Komitetit të Menaxhimit të Aktive Realizues, Anëtar i Këshillit Mbrojtës të Raffesien Leasing dhe anëtar i Këshillit Mbrojtës të Fondit të Pensioneve.

Bank of Albania (BA) | bankofalbania.org/ro/en/.../Funksionet-dhe-detyrat

Funksionet dhe detyrat

Në bazë të ligjit, Këshilli Mbrojtës ka kompetencat e mëposhtme:

1. Të miratosh politikat monetare të Republikës së Shqipërisë, duke përcaktuar kufijtë e operacioneve të Bankës së Shqipërisë në treg të hapur, përfshirjen e interesave për raportat në Bankën e Shqipërisë dhe për skemimet dhe huatë ose kredite e Bankës së Shqipërisë, si dhe të rezervave dhe nivelit të rezervave të detyrueshme që bankat e nivelit të dytë duhet të mbajnë në Bankën e Shqipërisë;
2. Të vendosë mbi rregullin dhe politiken e këmbimeve valutore të Republikës së Shqipërisë, si dhe të miratosh procedurat që përdoren për përcaktimin e vlerës së lekurit në raport me valutat e huaja;
3. Të miratosh të gjitha vendimet, rregullorët dhe udhëzimet me zbatim të përgjithshëm, që nihen nga Banka e Shqipërisë;
4. Të miratosh të gjithë raportet dhe rekomandimet që Banka e Shqipërisë i paraqet Kuvendi Popullor ose Këshilli të Ministrave;
5. Të përcaktosh vlerën nominale, prirjet dhe konfigurimin e kartemonedhëve dhe monedhave, si dhe kushtet e tërheqjes nga qarkullimi;
6. Të miratosh kredite ose huatë e Bankës së Shqipërisë për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë;
7. Të miratosh dhe rishikosh detyrimet e miratimit të paraspraktë dhe të licencave për udhëtimin e veprimtarisë bankare;
8. Të miratosh skemimin e instrumenteve me maturitet mbi tre muaj nga data e blerjes nga Banka e Shqipërisë, në zbatim të nenit 32, me përjashtim të paktën tre të pestave të anëtarëve të pranishëm të miratosh qëdo këndi, huazoj detyrimin tjetër të kushtëzuar të Bankës së Shqipërisë për një bankë në zbatim të nenit 16;
9. Të miratosh statutin dhe rregullorët e Bankës së Shqipërisë;
10. Të vendosë mbi politikën e administrimit të përgjithshëm, si dhe të përcaktosh mënyrat dhe procedurat e përdorimit të mjetëve financiare për zbatimin e veprimtarisë operative të Bankës së Shqipërisë;
11. Të përcaktosh strukturën organizative të Bankës së Shqipërisë;
12. Të miratosh emërimet e detyruesve të departamenteve të Bankës së Shqipërisë, të përcaktosh në përgjithësi kushtet e marrëdhënieve të punësimit në Bankën e Shqipërisë të agjentëve dhe korrespondentëve të Bankës së Shqipërisë;
13. Të vendosë për hapjen (dhe mbylljen e) rrjetëve (rregjeve ose agjencive të Bankës së Shqipërisë);
14. Të vendosë mbi buxhetin e Bankës së Shqipërisë;
15. Të propozojë mjete të kapitalit të Bankës së Shqipërisë dhe të vendosë mbi fondin e veçantë rezervë të Bankës së Shqipërisë të vendosë mbi të ardhurat neto të Bankës së Shqipërisë, si dhe mbi masën e të ardhurave neto që do të transferohet në rezervë;
16. Të miratosh raportet vjetore dhe raportet financiare të Bankës së Shqipërisë;
17. Të përcaktosh besatë me vlerë të brekshit që do të trajtohen si instrumente të parashitshme për investime nga Banka e Shqipërisë;

7.1.dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit; Mungon informacioni mbi mekanizmat monitorues dhe që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera. **Link-et e publikuar ndërlihen me faqen e KLSH dhe të QPZ;**

Mekanismet mundësi: raporte anulimi, dokumentet me tregues performancës	Neni 7/1 dh	Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë dhe Strategjia e Zhvillimit të Bankës së Shqipërisë 2016-2030	Mirënjohje për shërbimet të Rezolutës së BSH.	Në faqen zyrtare në rubrikën "Botime/Raport Vjetor" https://www.bankofalbania.org/Botime/Botime_Periodike/Raport_Vjetor/ Në faqen zyrtare në rubrikën "Strategjia" https://www.bankofalbania.org/Botime/Strategjia_dokumente_e_zhvillimit_te_Bankes_se_Shqiperise_2016_2030.html Në faqen zyrtare të Kontrollit të Lartë të Shtetit/Raport Auditimi http://www.dshsh.gov.al/Botime/Botime_Periodike/Auditimi_2014-2019 Në faqen zyrtare të Kuvendit/Rezoluta për veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë http://www.kuvend.gov.al/Botime/Botime_Zyrtare/2016/VTDI_201624-2016.pdf	Kabineti i Governmentit
Buxheti	Neni 7/1 dh	Buxheti	Faqe publike të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për BSH.	Në faqen zyrtare në rubrikën Botime (Raport Vjetor) https://www.bankofalbania.org/Botime/Botime_Periodike/Raport_Vjetor/ Në faqen zyrtare në rubrikën "Botime/Raport Mjeshë Statistikor"	Kabineti i Governmentit, Departamentet i Kërkimeve, Sekretari i
Informacion për procedurat e procedurimit.	Neni 7/1 dh	Raportet	Përditësimet	https://www.bankofalbania.org/Botime/Botime_Periodike/Raport_Mjeshë_Statistikor/ Në faqen zyrtare në rubrikën "Rreth Bankës/Njohje për tregues" https://www.bankofalbania.org/Rreth_Bankes/Njohje_për_tregues/ https://www.bankofalbania.org/Rreth_Bankes/Legjislacioni_Regullator_Nr_81_Par_qe_ndeletat_e_procedurimit_te_Bankes_e_Shqiperise.html Në faqen zyrtare në rubrikën Botime/Buletini Zyrtar https://www.bankofalbania.org/Botime/Botime_Periodike/Buletini_Zyrtar/	Kabineti i Governmentit, Departamentet i Administrimit, Departamentet i Kërkimeve

REPUBLICA E SHQIPERISE
KONTROLI I LARTE I SHETIT

Home | English

KLSH - Publikime - Auditime - Qeshkëqarime - Informacione - Projeke - Transparenca - Kontakt

Buletini i Auditimeve

Buletini i Auditimeve

viti 2019

- Buletini Nr. 1/2019 për periudhën Janar - Gershor 2019

viti 2018

- Buletini nr.4/2018
- Permbledhje Buletini nr.4, për periudhën Janar - Dhjetor 2018
- Permbledhje Buletini nr.3, për periudhën Janar - Shtator 2018
- Buletini i Auditimeve nr.3/2018
- Permbledhje Buletini nr.3 për periudhën Janar - Gershor 2018
- Buletini i Auditimeve nr.2/2018
- Permbledhje Buletini nr.1, për periudhën (Janar - Prill 2018)
- Buletini i Auditimeve nr.1/2018

viti 2017

- Permbledhje Buletini nr.4 për periudhën (Janar - Dhjetor 2017)
- Buletini i Auditimeve nr.4/2017
- Buletini i Auditimeve nr.3/2017
- Buletini i Auditimeve Nr.2/2017
- Buletini i Auditimeve nr.1/2017

viti 2016

Njoftime

Leta e Kryesit të KLSH-së Z. Leka, drejtor President të KLSH-së Zyrtarisht të Auditimit të Politisë dhe i asistues të drejtës së ligjit në këtë detyrë

Zgjedhjet Presidentiale të Zyrtarisht të Auditimit të Politisë

Leta e Kryesit të KLSH-së Z. Leka, drejtor ish Presidentit të Zyrtarisht të Auditimit të Politisë Z. Kwakowski

Njoftim mbi Auditimet e Performancës me temë "Nëse Kështu"

Elektronikisht i mësuesit dhe administrimit të tanit për të kështu

A vjetëri të pamatuesit akterë mësuesit në shërbim të ligjit të kushtetutës


Thirrje për bashkëpunim për Konferencën e Auditimeve të KLSH-së "Young ALSAI 2019"

Njoftim mbi auditimet e përfaqësimit me temë "Mendimet e Zonave të Mbrojtura Detare"

e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara. Mungon informacioni për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim;




ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit /partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, "Për prokurimin publik", dhe të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme; Mungon informacioni mbi: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;



f) informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit; **Informacioni gjendet i publikuar në faqe**

gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik; **Informacioni gjendet i publikuar**



h) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë; **Informacioni nuk gjendet i publikuar**

i) regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji. Informacioni është publikuar në faqen e autoritetit dhe është i përditësuar

A	B	C	D	E
298	22.03.2019	Kërkesë për informacion lidhur me të dhëna personale të të gjithë punonjësve të bankës	03.04.2019	U de
299	25.03.2019	Kërkesë për informacion lidhur me të dhëna personale të të gjithë punonjësve të bankës	25.03.2019	U de
300	25.03.2019	Kërkesë për informacion lidhur arsimimin e punonjësve në BSH	03.04.2019	U de
301	29.03.2019	Kërkesë për pranimin e çësjeve nga banka të nivelit të dytë	11.04.2019	U de
302	09.04.2019	Kërkesë për regjistrin e kredive	09.04.2019	U de
303	10.04.2019	Kërkesë për informacion lidhur me normat mesatare mujore e huave të reja në lekë të KJF, Individëve dhe OJF"	12.04.2019	U de
304	15.04.2019	Kërkesë për marrje informacioni lidhur me inflacionin dhe interesat nga banka	16.04.2019	U de
305	19.04.2019	Kërkesë për kurse këmbimi	25.04.2019	U de
306	24.04.2019	Kërkesë për informacion lidhur me kalendarin për ankandet e bonove të thesarit me afat 3 apo 5 vjeçar	25.04.2019	U de
308	30.04.2019	Kërkesë për normat e interesit bankar	03.05.2019	U de
309	08.05.2019	Kërkesë për informacion lidhur me librezat e kursimit para vitit 1990	20.05.2019	U de
310	09.05.2019	Kërkesë për kurse këmbimi	15.05.2019	U de
311	09.05.2019	Kërkesë nga OJF për informacion lidhur me përdorimin e euros nga subjektet tregtare	23.05.2018	U de
312	10.05.2019	Kërkesë për kurse këmbimi	15.05.2019	U de
313	11.05.2019	Kërkesë për informacion lidhur kushtet e punonjësve	11.05.2019	U de
314	14.05.2019	Kërkesë për kurse këmbimi	16.05.2019	U de
315	22.05.2019	Kërkesë për kurse këmbimi	23.05.2019	U de
316	22.05.2016	Kërkesë lidhur me raportin e kredimarrësit	22.05.2016	U de
317	29.05.2019	Kërkesë për kontrollin e veprimeve të arkës për një pagesë në një bankë të nivelit të dytë	10.06.2019	U de
318	30.05.2019	Kërkesë për normat e interesit	03.06.2019	U de
319	07.06.2019	Kërkesë për kurse këmbimi	17.06.2019	U de
307	05.06.2019	Kërkesë për kurse këmbimi	06.06.2019	U de

k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh; **Informacioni është publikuar në faqe por nuk është publikuar sipas formatit të programit model të transparencës.**

l) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik. **Informacioni është publikuar në faqe por nuk është publikuar sipas formatit të programit model të transparencës;**

Autoriteti Publik	Banka e Shqipërisë
Programi i transparencës	Po
Koordinatori	Po
7.1.a Përshkrim të strukturës, funksioneve dhe detyrave të A.P	Po
7.1.b: Tekst. e plota të konven, ligj, të akteve	Po
7.1.c Procedura për kërkesë për Informacion.	Po
7.1.ç Të dhënat e vendodhjes AP	Po
7.d Te dhënat për arsim,pagat	Po
7.1.dh Auditi	Pjesërisht
7. 1.e Buxheti	Pjesërisht
7.ë Procedurat e Prokurimit	Pjesërisht
7.1.f Shërbimet e Autoritetit Publik	Po
7.1.gj Mekanizma për dhënie e mend.hart.ligj	Po
7.1.h Mbajtja e dok(Arkiva)	Jo
7.i Regjistri i kërkesave	Po
7.1.k Dokumente që kërkohen shpesh	Po
7.1.l Çdo Informacion i dobishëm	Po